



Ndërmarrja publike lokale EKO-THERANDA

| | |
|------------------------|-------------------|
| NPL EKO THERANDA SH.A. | |
| Nr. | <u>16/2026</u> |
| Data | <u>31.03.2026</u> |
| SUHAREKË | |

Adresa: Rruga Brigada 123, Nr.2 , 23000 Suharekë NUI:812186999, e-mail: ekotherandasha@gmail.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ 01-2024, si dhe Rregullores për Procedurat e punësimit Nr.01-893/2, date 29.10.2024 Nr.01/2024, në bazë të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të NPL "EKO-THERANDA", nr.12/2025, nenit 26 pika 5 të kësaj rregullore, si dhe në bazë të Vendimit të Bordit të datës: 11.03.2026, Ndërmarrja Publike Lokale EKO-THERANDA Sh.A në Suharekë, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Vozites/e i mjeteve te renda- Shërbimin e Mirëmbajtjes- 1 (nje) pozite

I raporton: Kryepunëtorit/es në Shërbimin e Mirëmbajtjes

Niveli i pagës (koeficienti): 6.5

Përgatitja profesionale/shkollore: E mesme, shkathtësi në punë.

Përvoja e punës: Se paku gjashtë muaj

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e Kontratës: Me kohë të caktuar 12 muaj me mundësi vazhdimi varësisht nga nënshkrimi i kontratave me komunën (puna provuese 3 muaj)

Vendi Punës: Rr. "Brigada 123" nr.2, 23000 Suharekë (selia e NPL EKO-THERANDA)

Detyrat e përgjegjësitë:

1. Te jete i afte qe me orar te plote dhe pa kufizime te kryej detyrat e punës;
2. Kryen punët transportuese me këto automjete si dhe bartjen e punëtorëve duke ju përmbajtur Ligjit mbi sigurinë ne komunikacion;
3. Vozite dhe kryen veprime te punës me makina te renda me te cilat ngarkohet ose urdhërohet nga shefi;
4. Kujdeset për gjendjen teknike te makinave me te cilën manipulon dhe lajmëron me kohe defektet te cilat i vëren ose heton ne automjete;
5. Ne kuadër te aftësive te veta profesionale bene intervenime te imta dhe riparim te imët te automjetit;
6. Kryen kontrollimin e përditshëm të automjetit para daljes në komunikacion bënë evitimin e prishjeve të imta që kanë të bëjnë me vozitjen e automjetit;
7. Pastron e lubrifikon automjetin, kontrollon vajin lëndën e ftohjes në motor dhe agregatet tjerë të automjetit ,bënë kontrollimin dhe mirëmbajtjen e akumulatorëve, ndërrimin e filtrave si dhe të gjitha punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e automjetit;
8. Punën e makinës e arsyeton ne baze te urdhëresave te punës;
9. Kujdeset për regjistrimin me kohe te shpenzimeve te karburanteve dhe vajrave ne listën e evidencës sipas orëve te punës se makinës;
10. Është përgjegjës për servisimin dhe mirëmbajtjen e rregullt te makinave;
11. Kryen edhe pune te tjera ne baze te urdhrat te Zyrtarit për logjistikë;
12. Për punën qe e kryen përgjigjet Zyrtarit për logjistikë.

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet në mënyrë fizike tek zyra e NPL EKO-THERANDA e cila gjendet në objektin e Komunës së Suharekës Rr.Brigada 123 nr.2 ose në mënyrë elektronike në adresën: ekootherandasha@gmail.com (Dokumentet duhet të dorëzohen në formatin PDF).

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPL EKO-THERANDA i cili merret në zyret e NPL-së;
- Dëshmia e Shkollës së Mesme;
- Jetë Përshkrimi (CV);
- Dëshmia mbi përvojën e punës së paku 6 muaj;
- Patentë: B.M.L.T.C (Vozitës i mjeteve të rënda)
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon që nuk jeni i/e dënuar apo nën hetime (duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psiqike para nënshkrimit të kontratës (vetëm kandidati/ja i/e përzgjedhur)

***Shënim:** Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.*

NPL EKO-THERANDA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 01.04.2026 deri më 15.04.2026.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Administratën e NPL EKO-THERANDA e cila gjendet në objektin e Komunës së Suharekës Rr.Brigada 123 nr.2 apo ne email: ekootherandasha@gmail.com



NPL EKO-THERANDA" Sh.A.